



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 04 maj 2020
Nr. Ref.:RK 1556/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI179/19

Parashtrues

Ardian Ymeri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 196/2019, i 13 gusht 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ardian Ymeri të cilin në Gjykatë e përfaqëson Xhelal Ymeri (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev.nr.196/2019] të 13 gushtit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.5453/17] e 6 marsit 2019 të Gjykatës se Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr.142/2015] të 24 tetorit 2017 të Degës në Vitit të Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 4 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gerxhaliu-Krasniqi.
7. Më 29 tetor 2019, Gjykata njoftoj parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës dhe kërkoj nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzoj në Gjykatë certifikatën e lindjes dhe autorizimin e përfaqësuesit.
8. Më 26 shkurt 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme lidhur me regjistrimin e kërkesës.
9. Më 12 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
10. Më 15 prill 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Sipas shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte i siguruar në Kompaninë e Sigurimeve “Siguria” në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: kompania “Siguria”).
12. Më 9 nëntor 2008, parashtruesi i kërkesës kishte pësuar lëndime fizike në një aksidenti në komunikacion.
13. Më 18 nëntor 2009, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, përkatësisht prindit të tij, dhe kompania “Siguria” kishin lidhur një Marrëveshje Jashtëgjyqësore (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja) lidhur me kompensimin e dëmit pas aksidentit. Marrëveshja në fjalë përcaktoi kompensim për dëmin material dhe jomaterial në vlerën prej dymijë e katërqind e dhjetë (2,410.00) euro.
14. Më 18 mars 2010, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore, duke kërkuar anulimin e marrëveshjes të lartcekur jashtëgjyqësore, me pretendimin se e kishte nënshkruar duke mos e kuptuar përmbajtjen e saj.
15. Më 25 qershor 2013, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [C.nr.398/2009] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe konstatoi se Marrëveshja e kontestuar ishte në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të 30 marsit 1978 (në tekstin e mëtejme LMD).
16. Në një datë të paspecifikuar, kundër këtij Aktvendimi, parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që kërkesa e tij të miratohet si e bazuar dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
17. Më 20 prill 2015, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.2417/2013] e aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e anuloi Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore, duke konstatuar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore përkitazi me paragrafin 1 të nenit 182 të Ligjit nr. 04/L-118 të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK) në lidhje me paragrafët 1 dhe 3 të nenit 2 të tij, duke arsyetuar, në esencë se gjykata e shkallës më të ulët nuk kishte shqyrtuar kërkesëpadinë në tërësinë e saj, dhe vendosi që çështja të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore.
18. Më 24 tetor 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.142/2015] anuloi Marrëveshjen dhe duke e miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, e detyroi kompaninë “Siguria” që të kompensoj parashtruesin e kërkesës në vlerën prej tetë mijë e nëntëqind e dhjetë (8.910.00) euro, prej të cilës do të zbritet vlera tashmë e kompensuar bazuar në Marrëveshjen e kontestuar, për shkak të dëmit material dhe jo material. Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj, ndër të tjera, arsyetoi se Marrëveshja e kontestuar nuk “është në harmoni me dispozitat ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore”.

19. Në një datë të paspecifikuar, e paditura, përkatësisht kompania “Siguria” u ankua në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Themelore të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje. Përgjigje në ankesë ka paraqitur edhe parashtruesi i kërkesës.
20. Më 6 mars 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.5453/17] e shfuqizoj Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, dhe duke iu referuar neneve 1089 deri më 1094 të LMD-së, vendosi që Marrëveshja e kontestuar është në pajtim me ligjin e lartcekur.
21. Më 19 prill 2019, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i lartcekur të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje.
22. Më 13 gusht 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.196/2019] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [Ac.nr.5453/17] e 6 marsit 2019 të Gjykatës së Apelit, duke arsyetuar se Marrëveshja e kontestuar ishte lidhur në pajtim me dispozitat e LMD-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [Rev.nr.196/2019] i 13 gushtit 2019 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
24. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se në nxjerrjen e vendimeve të kontestuara, gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare dhe *“në kundërshtim me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut duke filluar nga nenin 1 e deri te dispozita e fundit ku garantohen të drejtat e njeriut para gjykatave, si dhe në kundërshtim me vet Kushtetutën e Republikës së Kosovës”*.
25. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa e tij të shpallet e pranueshme dhe të shpallet i pavlefshëm Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

29. Për sa i përket përmbushjes se këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 196/2019] e 13 gushtit 2019 të Gjykatës Supreme, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

30. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

31. Gjykata në këtë aspekt dhe fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës, kishte kontestuar në gjykatat e rregullta Marrëveshjen e nënshkruar më 18 nëntor 2009, bazuar në të cilën, ai ishte kompensuar në shumën prej dymijë e katërqind e dhjetë (2,410.00) euro përkitazi me aksidentin e vitit 2008, duke pretenduar kundërligjshmërinë e saj, sepse në esencë, sipas tij e njëjta ishte nënshkruar nën lajthim.
32. Çështja e parashtruesit të kërkesës ishte shqyrtuar përmes pesë (5) vendimeve gjyqësore, duke u vendosur fillimisht nga Gjykata Themelore e sipas të cilës, Marrëveshja ishte e ligjshme. Por më pas, e njëjta çështje ishte kthyer edhe një herë në të njëjtën gjykatë në rivendosje përmes Gjykatës së Apelit. Në rivendosje, Gjykata Themelore kishte konstatuar se Marrëveshja nuk ishte lidhur në pajtim me ligjin e aplikueshëm duke i akorduar parashtruesit të kërkesës një vlerë më të lartë kompensimi. Megjithatë, ky Aktgjykim ishte prishur në Gjykatë të Apelit dhe Aktgjykimi i kësaj të fundit, ishte konfirmuar nga Gjykata Supreme. Gjykata e Apelit dhe Supreme, respektivisht, kanë vlerësuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë konstatuar ligjshmërinë e Marrëveshjes së kontestuar. Parashtruesi i kërkesës konteston konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar se të njëjtat janë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse sipas pretendimit, Gjykata Supreme, nuk kishte marrë parasysh rrethanat dhe provat e tij dhe kishte interpretuar ligjin në mënyrë të gabuar, duke mos e shfuqizuar Marrëveshjen e 18 nëntorit 2009.
33. Lidhur me këtë pretendim, dhe siç është reflektuar tek pjesa që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesit të kërkesës në paragrafin 23 të këtij Aktvendimi, përtej pretendimit se vendimet e gjykatave të rregullta janë “arbitrare” dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur para Gjykatës asnjë argument dhe/ose arsyetim konkret përkitazi me shkeljet e të drejtave të tij e të cilat ai i pretendon.
34. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KIO2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe KIO5/19, parashtrues

Ruzhdi Bejta, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31).

35. Një qëndrim i tillë i Gjykatës, është i bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Bazuar në këtë praktikë, dhe atë tashmë të konsoliduar të Gjykatës, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).
36. Gjykata gjithashtu rikujton që të njëjtat pretendime të përgjithshme përkitazi me kundërligjshmërinë e Marrëveshjes së kontestuar ishin paraqitur edhe para Gjykatës Supreme përmes revizionit, dhe e cila kishte theksuar këtë fakt përmes Aktgjykimit të saj [Rev.nr.196/2019] të 13 gushtit 2019, duke theksuar si në vijim:

“Në revizionin e të autorizuarit të paditësit në mënyrë të përgjithshme thuhet se aktgjykimi i goditur me revizion përmban shkelej thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pa u sqaruar konkretisht se cilat janë ato, për me tepër në revizion vetëm është përshkruar përmbajtja e normës ligjore nga neni 182 pika(n) të LPK-së, pa dhen sqarime konkrete të mëtejme përkitazi me këtë shkelej procedurale, kështu që gjykata e revizionit konstaton se janë të pabazuara thëniet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale”.

37. Përkundër këtij konstatimi, Gjykata Supreme në fakt kishte arsyetuar në mënyrë të detajuar pretendimet e përgjithësuara të parashtruesit të kërkesës përkitazi me joligjshmërinë e Marrëveshjes së kontestuar dhe nënshkrimit të saj në lajthitje. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj, ndër të tjera, arsyetoi si në vijim:

“Këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pabazuara, për të njëjtat shkaqe dhe arsye të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit. Për më tepër, Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret përfaqësuesi ligjor i paditësit të mitur nuk ka qenë laik, gjë që shihet edhe në bazë të nënshkrimit të tij në marrëveshjen kontestuese dhe në shkresat tjera të lëndës, me asgjë nuk është vërtetuar se ai është laik apo i paaftë për të përfaqësuar denjësisht interesin e të birit të tij-këtu paditësit të mitur. Ai e ka kryer vet këtë veprim në përputhje me nenin 85.1 të LPK. Në nenin 10 të LMD është proklamuar parimi i lirisë së rregullimit të formave të marrëdhënieve të detyrimeve, ndërsa me nenin 26 të LMD parashihet qe kontrata quhet e lidhur kur palët kontraktuese të janë marrë vesh mbi pjesët përbërëse esenciale të kontratës. Në rastin konkret palët sipas vullnetit të tyre të lirë kanë lidhur kontratë pajtimi (marrëveshje jashtë gjyqësore) për kompensimin e dëmit në mënyrë jashtë gjyqësore

duke u marre vesh për kompensimin e të gjitha kategorive të dëmit të shkaktuar dhe me këtë është mbyllur mos marrëveshja në mes tyre lidhur me kompensimin e dëmit kontestues. Përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksident komunikacioni, është përgjegjësi kontraktuale, që themelohet me policen e sigurimit e cila zëvendëson kontratën e sigurimit. Sipas kësaj baze të përgjegjësisë e paditura ka përmbushur detyrimin e saj për kompensim dëmi dhe këtui përfundon obligimi kontraktues i sigurveesit. Me asnjë prove nuk është vërtetuar se kjo marrëveshje është lidhur nën ndikimin e lajthimit, mashtrimit apo dhunës apo se ekzistojnë të meta tjera në shprehjen e vullnetit të lirë me rastin e lidhjes se kësaj marrëveshjeje. Për këto arsye dhe arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së dytë, gjykata e revizionit konsideron se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë te drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit te kërkesëpadisë së paditësit”.

38. Gjukata në këtë kontekst thekson se gjykatat e rregullta dhe specifikuht Gjukata Supreme kishte konstatuar se Marrëveshja e kontestuar ishte në përputhje me dispozitat e LMD-së dhe se e njëjta ishte nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve.
39. Siç u sqarua më lart, parashtruesi i kërkesës para Gjukatës nuk sjell asnjë argument apo arsyetim shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese. Për pasojë, Gjukata bazuar në Rregulloren e saj të punës, përkatësisht paragrafin 2 të rregullit 39 të saj, duhet të shpallë këtë kërkesë të papranueshme si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
40. Gjukata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe, ndër të tjera, KI56/17, Aktvendim i 18 tetorit 2017, paragrafi 42).
41. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjukata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
42. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113. 7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20 e 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 15 prill 2020 njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi